



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:573/26, Datë:30.04.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 148 të mbajtur më 20.04.2026, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit Juridik – Universiteti i Prishtinës, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2029):
 1. *E drejta Penale LLM, (60 ECTS) me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik.*
 2. *E drejta Civile Pronësore LLM, (60 ECTS) me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik.*
- II. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit Juridik – Universiteti i Prishtinës, për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2031):
 3. *Të Drejtat e Njeriut, E Drejta Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësia Tranzicionale, LLM (60 ECTS) me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik.*
- III. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti Juridik – Universiteti i Prishtinës që deri më datë 30.09.2026 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Fakulteti Juridik – Universiteti i Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim vetëm nga KShC.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin/riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>E drejta Penale LLM, (60 ECTS)</i>	Flutura Tahiraj
2.	<i>E drejta Civile Pronësore LLM, (60 ECTS)</i>	Qerkin Berisha
3.	<i>Të Drejtat e Njeriut, E Drejta Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësia Tranzicionale, LLM (60 ECTS)</i>	Avni Puka

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin Juridik – Universiteti i Prishtinës.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këto programe dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *E drejta Penale LLM, (60 ECTS)***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 05 dhe 06.02.2026 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë:
 - Plotësisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.
 - Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *E drejta Civile Pronësore LLM, (60 ECTS)***, vizita me ekspert ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 05 dhe 06.02.2026 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë:
 - Plotësisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit;
 - Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit;
 - Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Të Drejtat e Njeriut, E Drejta Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësia Tranzicionale, LLM (60 ECTS)***, vizita me ekspert ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 05 dhe 06.02.2026 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë:
 - Plotësisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit
 - Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 148-të, të mbajtur më datë 20.04.2026, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të akreditimit të Fakultetit Juridik – Universiteti i Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit Juridik – Universiteti i Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

